

## Elseid Hysaj shenon ne humbjen e Empolit

nga Albaniassocer  
E enjte, 17 Prill 2014 23:17

---



Ne fushen e Lancianos sot ekipi toskan i Empolit ka humbur jo vetem ndeshjen por edhe vendin e dyte ne klasifikimin e Serise B. Ne minuten 4 te ndeshjes mbrojtesi shkodran, Elseid Hysaj, kaloi miqte ne avantazh por qe ne fund te ndeshjes nuk do te vlente sepse vendasit permbysen gjithqka duke shenuar dy here ne porten e bluve empolez. Tashme ne vendin e dyte te serise B eshte ngjitur Latina me 57 pike e ndjekur nga Empoli me 56. Ne vend te pare ndodhet Palermo e Ujkanit me 72 pike. Ujkani ishte ne stol. Ne barazimin 2-2 te Carpit me Modenen Memushaj luajti 90 minuta. Edgar Cani u aktivizua ne minuten 74 ne humbjen e Barit kunder Latines.